

CRS “STANDARTET E PËRBASHKËTA TË RAPORTIMIT”

Materiali i mëposhtëm ka vetëm qëllim informues, Banka Credins sh.a nuk jep konsulencë për qëllime tatimore. Për një informacion më të plotë mbi CRS-në, apo rezidencën tuaj për qëllime tatimore, mund të informoheni në: <https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/common-reporting-standard/>, si dhe të drejtoheni pranë autoriteteve tatimore apo kërkoni konsulencë të specializuar fiskale.

1. Pse po ju kërkojmë të plotësoni formular vetëdeklarimi ?

Për të mbrojtur integritetin e sistemit tatimore, qeveritë e vendeve në mbarë botën po paraqesin tek institucionet financiare dhe bankat një kërkesë të re për mbledhjen dhe raportimin e informacionit. Kjo njihet si Standarti i Përbashkët i Raportimit / Common Reporting Standard (the CRS). Sipas CRS, ne jemi të detyruar të përcaktojmë ku subjekti / shoqëria është “rezident tatimor” (zakonisht është vendi ku subjekti / shoqëria është e detyruar të paguaj tatime për shkak të vendndodhjes së selisë qendrore apo vendit të themelimit/organizimit, por në varësi të kushteve tuaja dhe parashikimeve të ndryshme midis legjislacioneve mund të jetë edhe një vend tjetër). Nëse subjekti/shoqëria ka rezidencë tatimore jashtë vendit/juridiksionit ku mbahet llogaria juaj, ne mund të kemi nevojë që këtë informacion t’ja japim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, së bashku me informacione të tjera të lidhura me llogarinë/të e subjektit / shoqërisë. Plotësimi i formularit të vetëdeklarimit, garanton që ne po mbajmë informacion të saktë dhe të azhurnuar në lidhje me rezidencën tatimore të subjektit / shoqërisë. Nëse rrethanat ndryshojnë, dhe nëse ndonjë nga informacionet e deklaruara nuk është më tej i saktë, jeni të lutur të na informoni dhe të plotësoni një formular të ri vetëdeklarimi.

2. Çfarë është Standarti i Përbashkët i Raportimit – CRS ?

CRS apo Standarti i Përbashkët i Raportimit është një standart global, i krijuar nga OECD në bashkëpunim me vendet e G20 dhe Bashkimin Europian dhe synon të realizojë shkëmbim të informacionit mbi llogaritë bankare/financiare të mbajtura në institucionet bankare apo financiare të një shteti, ndërmjet autoriteteve tatimore të shteteve anëtare të konventës. Shqipëria është bërë anëtare me nënshkrimin e marrëveshjes “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare” miratuar me Vendimin Nr.178, datë 9.3.2016 të Këshillit të Ministrave.

Sipas Ligjit 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, **Banka Credins**, sikur dhe bankat e tjera të nivelit të dytë dhe Institucionet Financiare në Republikën e Shqipërisë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, në marrëdhënie me klientët, duhet të identifikojë rezidencën e klientëve për qëllime tatimore dhe së bashku me informacione të tjera, si psh. Numri Identifikues si Tatimpagues, informacione mbi llogaritë/depozitat apo produkte të tjera bankare, të klientëve me rezidencë tatimore në një nga shtet anëtare të CRS - së, ti raportojë pranë autoriteteve tatimore të Republikës së Shqipërisë, të cilat më pas i shkëmbejnë me autoritetet tatimore të vendit të rezidencës së deklaruar nga Klienti.

3. Cili është vendi i rezidencës tatimore?

Çdo juridiksion ka rregullat e veta për përcaktimin e rezidencës tatimore, dhe në portalin e OECD-s për Shkëmbimin Automatik të Informacioneve, vendet/juridiksionet kanë vënë në dispozicion informacione për mënyrën si të përcaktohet që një subjekt është tatimpagues në këtë juridiksion apo jo. Në përgjithësi, një subjekt do të jetë rezident për qëllime tatimore në një vend/juridiksion nëse, sipas ligjeve të këtij të fundit (përfshirë konventat tatimore), ai paguan ose duhet të paguajë tatime për shkak të vendndodhjes së selisë qendrore, vendit të themelimit apo organizimit, ose çdo kriter tjetër i një natyre të ngjashme, dhe jo vetëm sepse burimi i të ardhurave është në atë vend/juridiksion. Një subjekt/entitet mund të ketë më shumë se një rezidencë tatimore. Nëse nuk jeni të sigurtë mbi vendin apo vendet në të cilat jeni tatimpagues, mund të merrni më shumë informacion në linkun: <https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/taxresidency/> ose pranë autoriteteve tatimore të vendit përkatës apo të kërkoni këshillim profesional fiskal apo ligjor.

4. Çfarë është TIN apo Numri Identifikues i Tatimpaguesit?

TIN apo Numri Identifikues i Tatimpaguesit ose një ekuivalent funksional në mungesë të një TIN-i është një kombinim unik shkronjash ose numrash që një juridiksion i cakton një subjekti/entiteti. Ai përdoret për të identifikuar një subjekt/entitet për qëllime tatimore.

Klientët e Bankës Credins sh.a. duhet të deklarojnë numrin e tyre identifikues për qëllime tatimore në formularët e përcaktuar në Bankë dhe nëse nuk kanë një të tillë, arsyet pse. Nëse keni nevojë për më shumë informacione mbi Numrin Identifikues të Tatimpaguesit për vendin apo vendet në të cilin jeni rezident lutem vizitoni linkun: <https://www.oecd.org/tax/automaticexchange/crs-implementation-and-assistance/tax-residency/>.

5. Informacione mbi formularin e Deklarimit të rezidencës tatimore sipas CRS

Deklarimi i rezidencës tatimore në formularët përkatës të Bankës është detyrim ligjor i parashikuar në Ligjin 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”. Banka Credins sh.a. nuk cel llogari/depozita bankare nëse klienti nuk deklaron rezidencën për qëllime tatimore dhe të dhënat shoqëruese me natyrë detyruese.

Formulari i vetëdeklarimit është i përbërë nga tri pjesë:

Pjesën 1: Të dhënat identifikuese të subjektit/entitetit titullar i llogarisë/depozitës.

Në pjesën e parë të formularit duhet të deklaroni të dhënat tuaja identifikuese si subjekt/entitet apo formë tjetër organizimi ligjor, psh. partneritet apo trust. Të dhëna të detyrueshme për tu deklaruar janë :

- ❖ **Rreshti i pare** : Emri ligjor i subjektit/entitetit apo degës ashtu si është në dokumentat përkatës të organizimit të subjektit/entitetit dhe regjistrimit pranë autoriteve kompetente sipas juridiksionit përkatës;
- ❖ Vendi në të cilin subjekti/entiteti është themeluar si person juridik, apo formë tjetër organizimi ligjor, apo vendin në bazë të legjislacionit të të cilit organizohet subjekti/entiteti;
- ❖ Adresa e rezidencës fiskale (të përfshijë numrin e apartamentit/godinës, emrin dhe numrin e rrugës, qyteti, shteti)
- ❖ Vendi/shteti në të cilin subjekti/entiteti ka rezidencën fiskale.

Pjesën 2 e Formularit të deklarimit të rezidencës


Duam t’ju vëmë në dukje se lloji i subjektit/forma e organizimit përzgjidhet nga klienti dhe bazohet në vetëdeklarim. Informacioni i mëposhtëm ka vetëm qëllim informues, Banka Credins sh.a. e ka të ndaluar të japë këshilla fiskale. Nëse keni nevojë për më shumë informacione mbi klasifikimin tuaj apo nëse jeni të paqartë mund të merrni më shumë informacione në linkun <https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/> ose të kërkontë asistencë pranë autoriteteve tatimore apo këshilliues fiskal.

Në procesin e vetëdeklarimit të rezidencës tatimore, përcaktimi nga Klienti i formës së organizimit në rastet kur ky është një subjekt/entitet është një moment shumë i rëndësishëm, për të garantuar që të dhënat tuaja mbahen nga banka dhe raportohen pranë autoriteteve kompetente në mënyrë të plotë dhe korrekte.

Në pjesën 2 të formularit të vetëdeklarimit duhet të përzgjidhni, çfarë lloj subjekti/entiteti jeni, bazuar në formën tuaj të organizimit. Klasifikimi i vendosur në formular është bazuar në klasifikimin e dhënë në Standartet e Përbashkëta të Raportimit të OECD - së.

Pjesa e dytë e formularit vlen dhe duhet të plotësohet nga të gjitha subjektet/entitetet, përfshirë edhe trustet, partneritetet apo organizata jofitimprurëse.

Banka Credins sh.a. ka të drejtë të kërkojë të paraqisni dokumenta shtesë për të mbështetur deklaratimet tuaja.





FI INSTITUCION FINANCIARË

INSTITUCION KUJDESTARIE

Njësia Ekonomike që mban, si pjesë thelbësore të biznesit të saj, Aktive Financiare për llogari të tjerëve. Konsiderohet se njësia ekonomike mban Aktive Financiare për llogari të tjerëve si pjesë thelbësore e biznesit të saj nëse të ardhurat bruto të njësisë ekonomike që i atribuohen mbajtjes së Aktiveve Financiare dhe shërbimeve financiare të lidhura me to, janë të barabarta me/ose i tejkalojnë 20% të të ardhurave bruto të Njësisë ekonomike gjatë periudhës më pak se:

- tre vjeçare që mbaron më 31 dhjetor (ose në ditën e fundit të periudhës kontabël të vitit jokalendarik) përpara vitit në të cilin bëhet përcaktimi; ose
- periudha gjatë së cilës Njësia Ekonomike ka ekzistuar.

“Të ardhurat që i atribuohen mbajtjes së Aktiveve Financiare dhe shërbimeve të lidhura me to” janë tarifatat për kujdestarinë, mirëmbajtjen e llogarisë dhe transfertat; komisionet dhe tarifatat e fituara nga ekzekutimi dhe vendosja e çmimeve për transaksionet e letrave me vlerë lidhur me Aktivet Financiare që mbahen nën kujdestari; të ardhurat e fituara nga dhënia e kredive për klientët lidhur me Aktivet Financiare që mbahen nën kujdes (ose të blera përmes zgjerimit të kësaj linje kredie); të ardhurat e fituara nga marzhi midis çmimit të kërkuar dhe atij të ofruar të Aktiveve Financiare që mbahen nën kujdes; dhe tarifatat.

INSTITUCION FINANCIARE DEPOZITUES

Njësia ekonomike që pranon depozita në funksionimin e zakonshëm të veprimtarisë bankare ose të ngjashme me të.

Njësia Ekonomike konsiderohet se është e angazhuar në “veprimtari bankare ose të ngjashme me to” nëse, gjatë funksionimit të zakonshëm të veprimtarisë së saj me klientë, Njësia Ekonomike pranon depozita ose investime të tjera të ngjashme fondesh dhe angazhohet rregullisht në një ose më shumë prej veprimtarive vijuese:

- a) jep kredi personale, hipotekare, biznesi ose të tjera, apo ofron linja të tjera kredie;
- b) blen, shet, zbrit ose negocion llogari të arkëtueshme, detyrime këstesh, nota, çeqe, kambiale, pranime bankare ose evidenca të tjera detyrimi;
- c) lëshon letër kredi dhe negocion çeqe të plotësuara në bazë të tyre;
- d) ofron shërbime trusti ose besimi;
- e) financon transaksionet e këmbimit valutor; ose
- f) hyn në, blen ose zgjidh qira financiare ose aktive të dhëna/marra me qira.

SHOQERI SIGURIMESH E SPECIFIKUAR/JETE

Njësia Ekonomike që është një shoqëri sigurimesh (ose shoqëria kontrolluese (*holding*) e shoqërisë së sigurimeve) që lëshon ose është e detyruar të kryejë pagesa lidhur me Kontratat e Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme ose Kontratat e Pensionit Vjetor.

SHEMBULL:

Banke Kujdestare,
Broker ne tituj
Depozitar Qendror,
Shtepi Klerimi,

SHEMBULL

Banka tregtare
Shoqeri Kursim
Krediti (SHKK)
Unionet e Shoqerive te
Kursim Kreditit

SHEMBULL

Shoqeri sigurimi jete

FOND INVESTIMI

Njësia Ekonomike që ushtron veprimtari biznesi të investimeve për llogari të personave të tjerë, dhe Njësitë që menaxhohen nga ato Njësi Ekonomike ose Institucione të tjera Financiare.

Tipi 1:

Fond Investimi i ndryshem nga tipi 2

Një Njësi ekonomike që ka si biznes një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme për/ose në emër të klienteve:

- Tregtimi i instrumenteve të tregut të parave (çeqe, fatura, certifikata depozitash, derivate, etj.); këmbim valutor; instrumentet e këmbimit valutor, normës së interesit dhe të indeksit; letrat me vlerë të transferueshme; ose tregtimi mallrave përmes kontratave të ardhshme;
- Menaxhimi i portofolit individual dhe kolektiv; ose
- Në të kundërt investon, administron ose menaxhon asetet financiare ose paratë në emër të personave të tjerë.

Në këto aktivitete ose operacione nuk përfshihet që një klienti t'i jepen këshilla investuese, të cilat nuk janë të detyrueshme.

Tipi 2: Fond Investimi i menaxhuar/administruar nga një Institucion tjetër Financiare

Një Njësi ekonomike të ardhurat bruto të të cilit gjenerohen kryesisht nga investimi, riinvestimi ose tregtimi i Aseteve Financiare, ku subjekti/njësia ekonomike menaxhohet nga një subjekt tjetër që është një Institucion depozitues, një Institucion Kujdestarie, një kompani Sigurimesh ose Tipi 1 i Fondit të Investimeve.

Një subjekt "menaxhohet/administrohet" nga një subjekt tjetër në rast se subjekti administrues kryen, drejtpërdrejt ose përmes një ofruesi tjetër shërbimi në emër të subjektit të menaxhuar, ndonjë prej veprimtarive ose operacioneve të përcaktuara në përkufizimin e Tipit 1 të Fondit të Investimit.

SHENIM:

Nëse je një Fond Investimi me seli në një vend/juridiksion jo-pjesëmarrës dhe që menaxhohet nga një Institucion tjetër Financiar duhet të plotësosh në formularin e vetëdeklarimit pronarin e fundit përfitues/personin kontrollues.



**INSTITUCION JOFINANCIARE AKTIV
[NFE AKTIVE]**

NFE aktive për shkak të të ardhurave

Kur më pak se 50% e të ardhurave bruto të NFE-së për vitin paraardhës kalendarik ose një periudhë tjetër të përshtatshme raportimi janë të ardhura pasive dhe më pak se 50% të aktiveve që mbahen nga NFE-ja gjatë vitit paraardhës kalendarik ose një periudhe tjetër të përshtatshme raportimi janë aktive që gjenerojnë ose që mbahen për gjenerimin e të ardhurave pasive.

NFE aktive Banke Qendrore

Një bankë e krijuar me ligj ose akt tjetër shtetëror dhe që ka të drejtë të hedh në qarkullim monedhën në një vend/juridiksion të caktuar.

NFE aktive shtetërore

Një Ent Qeveritar, përfshirë një shoqëri tregtare, në pronësi të institucioneve të pushtetit Qendror apo Vendor.

NFE në proces likuidimi

Një NFE që nuk ka qënë një Institucion Financiarë në 5 vitet e fundit dhe është në proces likuidimi ose po riorganizohet në qëllim riorganizimit apo fillimin e një biznesi që është i ndryshëm nga ai i Institucionit Financiarë

NFE start up

Një NFE që ende nuk po ushtron veprimtari biznesi dhe nuk ka asnjë historik të mëparshëm veprimtarie të tilla. NFE-ja po investon kapital në aktive me synimin për të ushtruar një veprimtari biznesi, e cila nuk është veprimtari e Institucionit Financiar dhe nuk duhet të kenë kaluar 24 muaj nga krijimi/organizimi i entitetit ;

NFE pjesë e një grupi jofinanciare

Kur NFE-ja angazhohet kryesisht në financimin dhe mbrojtjen e transaksioneve me, ose për, njësitë ekonomike të lidhura që nuk janë institucione financiare, dhe nuk i ofron shërbime financimi ose mbrojtjeje asnjë njësie ekonomike që nuk është njësi ekonomike e lidhur, me kusht që grupi i çdo njësie të tillë ekonomike të lidhur është kryesisht i angazhuar në një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar

NFE aktive Organizatë Ndërkombëtare

Një organizatë ndërkombëtare me karakter supranacional, e krijuar nga shtete të ndryshme.

NFE e tregtuar në bursë

Një NFE aktive, subjekt jofinanciare aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të rregulluar letrash me vlerë (bursë) ose një shoqëri e lidhur me të.

NFE-ja pjesë e një grupi jofinanciare

Një NFE që angazhohet kryesisht në financimin dhe mbrojtjen e transaksioneve me, ose për, njësitë ekonomike të lidhura që nuk janë institucione financiare, dhe nuk i ofron shërbime financimi ose mbrojtjeje asnjë njësie ekonomike që nuk është njësi ekonomike e lidhur, me kusht që grupi i çdo njësie të tillë ekonomike të lidhur është kryesisht i angazhuar në një biznes të ndryshëm nga ai i institucionit financiar



ENTITET JOFINANCIARE PASIVE
NFE PASIVE

NFE pasive është	
1. Një subjekt/njësi ekonomike që nuk është një NFE aktive	2. Një Fond Investimi me seli në një vend/juridiksion jo-pjesëmarrës dhe që menaxhohet nga një Institucion tjetër Financiar
Nëse subjekti/entiteti juaj është një NFE pasive çdo pronar i fundit përfitues/person kontrollues duhet të Vetëdeklarojë rezidencën tatimore në formularët përkatës në Bankë.	
<p><u>Pronar i fundit përfitues:</u></p> <p>Është individi i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të një përqindje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votimit ose të pjesëmarrjen në kapitalin e atij entiteti, përfshirë përmes mbajtjes së aksioneve, ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, ose përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij, sipas Ligjit Nr.112/2020 “Për rregjistrin e Pronarëve Përfitues”.</p>	

Shënim: Nëse subjekti/entiteti juaj është një subjekt/entitet jofinanciar pasiv, NFE pasive ose një Fond Investimi me seli në një vend/juridiksion jo-pjesëmarrës dhe që menaxhohet nga një Institucion tjetër Financiar, administratori i subjektit/entitetit apo personi i autorizuar prej tij, në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, do duhet të deklarojë emrin/emrat e pronave të fundit përfitues/personat kontrollues të subjektit/entitetit. Gjithashtu secili prej pronarëve të fundit përfitues duhet të plotësojë formularët përkatës të bankës dhe të deklarojë rezidencën fiskale.

Shpjegime të tjera:

Të ardhurat Pasive përgjithësisht do të konsiderohen se përfshijnë pjesën e të ardhurave bruto që përbëhen nga:

- ❖ Dividentet
- ❖ Interesat
- ❖ Tepricat e fitimeve nga valuta e huaj mbi humbjet nga valuta e huaj.
- ❖ Qirate dhe pagesat nga përdorimi i pronës, të ndryshme nga qiratë dhe pagesat për përdorimin e pronës që vijnë gjatë kryesjes së biznesit në mënyrë aktive nga punonjësit e një subjekti jofinanciar, NFE
- ❖ Të ardhurat neto nga swaps-et; ose shumat e marra sipas Konventave të Sigurimit në Vlerë në Para të Gatshme.
- ❖ Tepricat e fitimit mbi humbjet nga transaksionet (duhe përfshirë kontrata future, forward, opsionet dhe transaksione të ngjashme në çdo Aktive Financiare).

Pjesa 3: Deklarimi i vendit/juridiksionit të rezidences tatimore dhe TIN-I;

Në pjesën e tretë të formularit duhet të deklaroni vendin/juridiksionin në të cilin jeni rezident për qëllime tatimore. Nëse keni residence tatimore në më shumë se një vend/juridiksion duhet të deklaroni të gjithë vendet/juridiksionet. Nëse subjekti/entiteti juaj është i pajisur me një TIN, Numer identifikues apo numer ekuivalent duhet ta deklaroni në formular, për secilin nga vendet/juridiksionet në të cilat jeni rezident për qëllime tatimore. Nëse nuk keni një TIN apo nuk jeni pajisur akoma me një të tillë, duhet të deklaroni arsyet pse nuk keni një TIN apo pse ende nuk e keni një të tillë.

Pjesa 4: Deklarimi dhe nënshkrimet

Sigurohuni që keni të drejtën/autoritetin për të nënshkruar për subjektin/entitetin titullar të llogarise/depozites dhe në fund nënshkruani dhe vendosni datën e plotësimit dhe nënshkrimit të formularit.

6. Çfarë detyrimesh ka Banka Credins sipas Ligjit 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit” ?

Sipas ligjit 4/2020 Banka Credins detyrohet të identifikojë rezidencën tatimore të klienteve që kanë llogari/depozita ekzistuese në banke apo që do çelin të tilla në të ardhmen. Identifikimi i rezidences tatimore bëhet nëpërmjet deklaramit të të dhenave, përfshirë vendin apo vendet në të cilat klienti është rezident për qëllime tatimore dhe Numrin Identifikues si Tatimpagues, në formularët e përcaktuar nga Banka.

Sipas Ligjit 4/2020 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Banka Credins, mbledh dhe ndan me autoritetet tatimore shqiptare dhe juridiksionin/juridiksionet në të cilat klienti është rezident për qëllime tatimore, informacionin e mëposhtem:

- ❖ Emrin, adresën, vendin/vendet e rezidences tatimore, Numrin Identifikues si Tatimpagues.
- ❖ Numrin e llogarive/depozitave apo produkte të ngjashme pavarësisht emertimit
- ❖ Balancën e llogarise/depozites për vitin përkatës
- ❖ Shumën totale bruto të interesave të gjeneruara gjatë vitit, si dhe çdo informacion tjetër të përcaktuar me akt ligjor apo nënligjore nga autoritet kompetente të Republikës së Shqipërisë.
- ❖ Për individin, pronar të fundit përfitues/personin kontrollues të një NFE pasive ose Fondi Investimi me seli në një vend/juridiksion jo-pjesëmarrës dhe që menaxhohet nga një Institucion tjetër Financiar, përveç të dhenave sa më sipër transferohet edhe datelindja dhe vendlindja.

Banka Credins sh.a. në momentin e çeljes së llogarise/depozites apo në çdo moment tjetër gjatë kohezgjatjes së marrëdhënies, ka të drejtë të kërkojë nga klientet përveç deklaramit të rezidences tatimore edhe paraqitjen e dokumentave justifikues për deklarimet e bëra.

Shënim: Të dhenat tuaja të deklaruara në Banke, do të përpunohen në përputhje me Ligjin Nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Klientet e Bankës Credins në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në Ligj. Banka CREDINS mbron të dhënat në ambiente dhe sisteme të sigurta deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në Udhëzimin Nr.20 datë 03/08/2012 të Komisionerit të DIMDP-le më pas të dhënat shkatërrohen.